



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.51**

**2006**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.214, datë 29.3.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e zgjedhjes dhe rregullimin e marrëdhënieve të shoqërive, që do të ndërtojnë dhe përdorin instalime bregdetare, për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.....	1499
Udhëzim MPÇSSHB nr.646/1, datë 15.5.2006	Mbi disa ndryshime në udhëzimin nr.646, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional”.....	1500
Udhëzim MPÇSSHB nr.647/1, datë 15.5.2006	Mbi disa ndryshime në udhëzimin nr.647, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra”.....	1501
Udhëzim MPÇSSHB nr.648/1, datë 15.5.2006	Mbi disa ndryshime në udhëzimin nr.648, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”.....	1502

Udhëzim MPCSSHB nr.649/1, datë 15.5.2006	Mbi disa ndryshime në udhëzimin nr.649, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë””.....	1503
Udhëzim i MMPAU nr.3, datë 17.5.2006	Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret.....	1504
Vendim i KKRT nr.457, datë 11.5.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit “TV A 1”.....	1507
Vendim i KKRT nr.458, datë 11.5.2006	Për dhënie licence.....	1509
Vendim i KKRT nr.460, datë 11.5.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Gramshi”.....	1509
Vendim i KKRT nr.461, datë 11.5.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV ARV”.....	1510

**VENDIM**  
**Nr. 214, datë 29.3.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.30, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E  
MARRËDHËNIEVE TË SHOQËRIVE, QË DO TË NDËRTOJNË DHE PËRDORIN  
INSTALIME BREGDETARE, PËR TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS,  
GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Për vlerësimin e kërkesave dhe të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë, sipas përcaktimit të pikës 2 të vendimit, të ngrihet komisioni i vlerësimit të kërkesave, me këtë përbërje:

- |  |            |
|--|------------|
| - Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës               | 4 anëtarë; |
| - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit | 2 anëtarë; |
| - Ministria e Financave  | 1 anëtar;  |
| - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave      | 1 anëtar;  |
| - Ministria e Brendshme  | 1 anëtar;  |
| - Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve            | 1 anëtar.  |

Kryetari i komisionit caktohet nga ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

2. Kudo në vendim emërtimet “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” dhe “Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë”, zëvendësohen me “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” emërtimet “Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit” dhe “Ministria e Transportit”, zëvendësohen me “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”, emërtimi “Ministria e Mjedisit”, zëvendësohet me “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr. 646/1, datë 15.5.2006**

**MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 646, DATË 20.03.2006 “MBI ZBATIMIN E  
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.74, DATË 11.02.1999  
“PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET MBËSHTETJES SË  
FORMIMIT INSTITUCIONAL””**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit institucional” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr.646, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

“Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Paragrafi “ç” i pikës 3 riformulohet si vijon:

“ç) Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.”

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja “... 418 datë 25.02.2004 të ...”, zëvendësohet me lidhëzën “e”.

4. Pika 6 riformulohet si vijon:

“Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Tripalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.”

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

“Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në paragrafin e parë të pikës 24 shprehja “... të Këshillit Administrativ Tripalësh ...” hiqet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE  
DHE SHANSEVE TË BARABARTA  
Koço Barka**

**UDHËZIM**  
**Nr. 647/1, datë 15.5.2006**

**MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.647, DATË 20.03.2006 “MBI ZBATIMIN E  
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 632, DATË 11.02.1999 “PËR  
PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA  
FEMRA””**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papuna femra” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr.647, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papuna femra”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

“Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin “e” shprehja në kllapa “(për të paktën 1 vit)” zëvendësohet me shprehjen “(për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare)”

Pika “i” riformulohet si vijon:

“i) Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.”

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja “... 418 datë 25.02.2004 të ...”, zëvendësohet me lidhëzën “e”.

4. Në pikën 5 fjalia e dytë riformulohet si vijon:

“Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Tripalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.”

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

“Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në pikën 22 fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Zyra e punësimit merr masa për zëvendësimin e punëmarrësve të larguar.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE  
DHE SHANSEVE TË BARABARTA  
**Koço Barka**

**UDHËZIM**  
**Nr. 648/1, datë 15.5.2006**

**MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 648, DATË 20.03.2006 “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 73, DATË 11.02.1999 “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË””**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit” i ndryshuar”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr.648, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

“Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin “d.” shprehja në kllapa “(për të paktën 1 vit)” zëvendësohet me shprehjen “(për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare)”

Pika “f” riformulohet si vijon:

“f) Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.”

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja “... 418 datë 25.02.2004 të ...”, zëvendësohet me lidhëzën “e”.

4. Në pikën 5 fjalia e dytë riformulohet si vijon:

“Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Tripalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.”

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

“Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në pikën 16 fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Zyra e punësimit merr masa për zëvendësimin e punëmarrësve të larguar.”

7. Në paragrafin e parë të pikës 24, shprehja “... të Këshillit Administrativ Tripalësh ...” hiqet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE  
DHE SHANSEVE TË BARABARTA  
**Koço Barka**

**UDHËZIM**  
**Nr. 649/1, datë 15.5.2006**

**MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 649, DATË 20.03.2006 “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 69, DATË 11.02.1999 “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË””**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr.649, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

“Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë së një periudhë njëvjeçare;

ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin “d.” shprehja në kllapa “(për të paktën 1 vit)” zëvendësohet me shprehjen “(për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare)”

Pika “f” riformulohet si vijon:

“Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.”

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja “... 418 datë 25.02.2004 të ...”, zëvendësohet me lidhëzën “e”.

4. Në pikën 5 fjalia e dytë riformulohet si vijon:

“Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Tripalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.”

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

“Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në pikën 21 fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Zyra e punësimit merr masa për zëvendësimin e punëmarrësve të larguar.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE**  
**DHE SHANSEVE TË BARABARTA**  
**Koço Barka**

**UDHËZIM**  
**Nr. 3, datë 17.5.2006**

**PËR PLANET E REHABILITIMIT TË SIPËRFAQEVE TË DËMTUARA NGA GURORET**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të gurmës “ç” të nenit 66, të ligjit nr.8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”,

**UDHËZOJ:**

1. Personat fizikë e juridikë, që çelin gurore për shfrytëzim inertesh apo mineralesh, janë të detyruar të rehabilitojnë habitatet që dëmtojnë me veprimtarinë e tyre.

2. Rehabilitimi i sipërfaqeve (habitateve) të dëmtuara nga guroret është pjesë e pandarë e veprimtarisë shfrytëzuese të tyre. Ai parashikohet, planëzohet e zhvillohet njëkohësisht dhe krahas veprimtarisë shfrytëzuese dhe vazhdon pas përfundimit të saj, deri sa habitatit të jetë rehabilituar plotësisht.

3. Rehabilitimi i habitateve të dëmtuara nga guroret kryhet sipas planeve të rehabilitimit të tyre, të cilët paraqiten nga subjektet e këtyre aktiviteteve në agjencinë rajonale të mjedisit të qarkut ku do të hapë guroren, si pjesë e dokumentacionit për t’u pajisur me leje mjedisore.

4. Për subjektet që janë duke shfrytëzuar guroret, por nuk kanë plan rehabilitimi dhe nuk kanë kryer veprime për të rehabilituar habitatin, plani i rehabilitimit paraqitet në agjencinë rajonale të mjedisit të qarkut përkatës, brenda dy muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Kur kjo kërkesë nuk zbatohet, Inspektorati i Mjedisit pezullon punimet deri në dorëzimin e planit të rehabilitimit.

5. Personat fizikë e juridikë që kanë përfunduar aktivitetin e shfrytëzimit të gurores dhe nuk e kanë rehabilituar habitatin që kanë dëmtuar, mbeten të detyruar për ta rehabilituar atë ose duke zbatuar kërkesat e këtij udhëzimi ose do të detyrohen gjyqësisht.

6. Inspektorati i Mjedisit evidenton sipas qarqeve subjektet juridike e fizike të cilat nuk kanë planin e rehabilitimit të sipërfaqeve rreth dhe në brendësi të guroreve dhe u kërkon hartimin dhe zbatimin e tij, gjatë gjithë fazave të operacioneve të punimeve. Subjektet që nuk i përgjigjen kësaj kërkesë, paditen në gjykatë për shpërblimin e dëmeve që i kanë shkaktuar mjedisit.

7. Plani i rehabilitimit është dokumenti që përmban projektin e rehabilitimit dhe afatet kohore për kryerjen e punimeve rehabilituese. Projekti shoqërohet me përshkrimet përkatëse dhe me fotografi që qartësojnë gjendjen e habitatit para përdorimit për gurore.

8. Plani i rehabilitimit shqyrtohet dhe miratohet në procesin e dhënies të lejes mjedisore. Personi fizik apo juridik që ka paraqitur planin, mund të ankohet me shkrim te Ministri për aspekte të planit të miratuar që i vlerëson të padrejta, brenda 20 ditëve nga marrja e tij. Ministri i përgjigjet ankesës brenda 30 ditëve nga regjistrimi i saj në protokollin e Ministrisë. Ndaj përgjigjes së Ministrisë apo kur ky nuk është përgjigjur në afat, ankuesi mund t’i drejtohet gjykatës, brenda 30 ditëve nga marrja e përgjigjes apo nga skadimi i afatit.

9. Plani i rehabilitimit trajton detyrimisht masat dhe veprimet për sistemimin dhe përgatitjen e vendit, për parandalimin e erozionit, për gjelbërimin dhe rigjelbërimin, si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme që sigurojnë mirëmbajtjen e habitatit.

10. Masat rehabilituese në planet e rehabilitimit identifikohen në përputhje me karakteristikat e vlerat e habitatit. Ato jepen të detajuara, duke u grupuar në:

- a) punime inxhinierike;
- b) punime biologjike.

11. Rigjelbërimi i habitatit me bimësi kryhet, duke i dhënë përparësi bimëve autoktone, të përshtatshme me zonën, që kanë ekzistuar para hapjes së gurores, si dhe bimësisë tjetër që është në përputhje me tipin e tokës.

12. Llojet pyjore që përdoren për ripyllëzimin e sipërfaqes rreth dhe në brendësi të gurores rekomandohen, duke pasur parasysh :

a) për mbrojtjen e tokave nga erozioni të përdoren llojet fletore përherë të blerta ;  
b) për veshjen e terreneve shkëmbore të përdoren llojet pyjore të cilat kanë sistem rrënjor të fuqishëm, e mbajnë të mbuluar tokën edhe gjatë stinëve me rreshje të bollshme dhe e lidhin mirë atë;

c) për terrene me shfaqje të erozionit duhet të përdoren dhe llojet që lidhin mirë terrenin dhe ndihmojnë parandalimin e erozionit;

d) për terrene të eroduara, krahas fidanëve, të përdoret edhe mbjellja me farë.

13. Pyllëzimet e ripyllëzimet e terreneve të degraduara, pasi përfundojnë, i dorëzohen me dokumente të rregullta Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, e cila i vë në ruajtje dhe i mbron për një periudhë 20-vjeçare për të bërë të mundur rimëkëmbjen e tyre.

14. Kriteret për vlerësimin e rehabilitimit të habitatit të dëmtuar nga guroret përfshijnë:

a) zona e rehabilituar të rikthehet në një gjendje të qëndrueshme dhe jo ndotëse;

b) zona të jetë kthyer në gjendje të përshtatshme për përdorimin e mëtejshëm të planifikuar;

c) zona nuk duhet të preket nga erozioni;

d) rigjëlberimi të jetë efektiv në të gjithë sipërfaqen e habitatit, duke vlerësuar densitetin e fidanëve, larminë e llojeve dhe mbulesën bimore, siç është parashikuar në planin e miratuar të rehabilitimit.

15. Në raportimet periodike që bëjnë subjektet për rezultatet që u dalin nga vetëmonitorimi i veprimtarisë që zhvillojnë, punët dhe veprimet që kanë bërë për rehabilitimin e habitatit të raportohen si zë i veçantë.

16. Inspektorati i Mjedisit, në kontrollet që ushtron mbi guroret, ndjek zbatimin e planit të rehabilitimit, duke marrë masa e duke lënë detyra që garantojnë zbatimin e tij.

17. Pas mbarimit të të gjitha operacioneve rehabilituese, subjekti mund të kërkojë nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor dokumentin që vërteton se rehabilitimi i habitatit ka përfunduar në mënyrë të kënaqshme dhe në përputhje me kërkesat e planit të rehabilitimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE  
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
**Lufter Xhuveli**

## SHTOJCË

### ÇËSHTJE PËR T'U TRAJTUAR NGA PLANET E REHABILITIMIT TË SIPËRFAQEVE TË GURORAVE DHE MASA TË SUGJERUARA PËR REHABILITIMIN

#### 1. Përkufizimi

Rehabilitimi përfshin të gjitha ato masa të cilat synojnë të riaftësojnë tokën e degraduar dhe t'i kthejnë këto toka në një gjendje të qëndrueshme dhe të pandotur.

#### 2. Objektivat

Synimet kryesore të punës rehabilituese janë:

- Të arrihet një stabilizim i zonave të dëmtuara nëpërmjet ndërhyrjeve hidroteknike për të minizuar ndër të tjera erozionin.

- Të rigjëlberojë të gjitha zonat e eroduara me specie të përshtatshme bimore, që kanë ekzistuar më parë.

- Të minimizojë ndikimin pamor të zonave të degraduara e të përmirësojë peizazhin.

#### 3. Sistemimi dhe përgatitja e vendit

Hapi i parë në operacionin e rehabilitimit është pastrimi i përgjithshëm dhe sigurimi i zonës.

Masa të sugjeruara

Punimet e pastrimit të vendit që ndërmerren pas ndërprerjes së veprimtarisë përfshijnë:

- heqja dhe ndalimi i zhvillimit të veprimtarive që kanë karakter përpunimi (fraksionim guri) apo përgatitje betoni në afërsi të karierave;

- largimin e të gjitha pajisjeve të fiksuara dhe të palëvizshme, të përkohshme dhe të përhershme;

- largimi dhe eliminimi i duhur i të gjitha mbetjeve përfshirë ato të rrezikshme;

- rehabilitimi i rrugëve dhe vendit të zyrave;

- pas pastrimit të vendit mund të jetë i nevojshëm pengimi i hyrjes së makinave në vend duke ngritur gardhe për të parandaluar hyrjen e makinave, motoçikletave, njerëzve dhe kafshëve deri në rehabilitimin e zonës.

Hapi i parë në procesin e përgatitjes përfshin rimodelimin e zonës. Përdorimi përfundimtar i tokës do të përcaktojë formën e relievit. Vendi duhet të modelohet në mënyrë të tillë që të harmonizohet me peizazhin rrethues. Vendi duhet lënë në një gjendje të qëndrueshme, lehtësisht të kulluar që të harmonizohet me zonën rrethuese.

Shtresa e tokës duhet të ripërhapet në mënyrë uniforme mbi zonë në një thellësi të përshtatshme për të mbështetur rigjëlberimin.

Kur mungon shtresa e tokës, duhen kërkuar alternativa në materiale argjile të pranishme në vend, në mbulesë minerale ose shkëmbinsh sedimentare që përfshin një përmbajtje të lartë plurur minerali, shkëmb shumë të thërmuar ose shtresë dheu që mund të merret nga vendet e ndërtimit, por duhet përshtatur në ngjyrë pa prishur peizazhin.

Të gjitha zonat e ngjeshura duhet të punohen thellë përgjatë konturit. Kjo mund të kryhet përpara ose pas përhapjes së shtesës së dheut.

### 3. Rigjëlberimi dhe gjëlberimi

Vegjetacioni është stabilizuesi më i mirë i mirëmbajtjes së thjeshtë të zonave të degraduara në periudhë afatgjatë. Rigjëlberimi i shërben parandalimit të erozionit.

Rigjëlberimi gjithashtu minimizon ndikimin e ndërhyrjes pamore.

Masa të sugjeruara

Rigjëlberimi duhet të synojë instalimin e bimëve autoktone. Instalimi i tipeve të vegjetacionit jo autokton shpesh kërkon më shumë burime se riinstalimi i vegjetacionit origjinal. Tokat për llojet e huaja duhet të jenë relativisht pjellore dhe mund të jenë të nevojshme trajtimet e mirëmbajtjes, si plehërimi dhe krasitja.

Shtresa e materialit organik me të cilin mbulohet sipërfaqja e tokës për të parandaluar erozionin rreth fidanëve që rriten, mund të reduktojë barërat e këqija dhe të ruajë lagështinë e tokës dhe shtimin e ushqyesve dhe lëndës organike të dobishme. Ndër materialet që mund të përdoren përfshijnë: komposto, mbetje druri, copëra, pluhura sharre, kashtë, levore etj.

### 4. Mbjellja

Në rastet më të shumta, rigjëlberimi i guroreve do të përfshijë riintroduktimin e llojeve të bimëve të përshtatshme për të plotësuar rigjenerimin me anë të erës ose farës së ruajtur në tokë. Ky riintroduktim mund të jetë në formën e fidanëve të shtuar në fidanishte ose aplikimi i drejtpërdrejtë të farës në shtratin e farës të përgatitur.

### 5. Monitorimi dhe mirëmbajtja

Rehabilitimi është një proces që mund të shkojë me vite për të dhënë një ekosistem të qëndrueshëm dhe vetëqëndrues. Kujdesi i mëpastajshëm është vitalisht i rëndësishëm dhe çdo dështim duhet të riparohet shpejt.

Masa të sugjeruara

Zonat e rehabilituara duhet të inspektohen rregullisht për të vlerësuar shëndetin e vegjetacionit dhe kontrolluar për erozion, dëmtim nga kullotja dhe ndotje nga barërat e këqija. Inspektime të përvitshme mund të kërkojnë në disa zona më të mëdha pas ndërprerjes së operacioneve për të siguruar suksesin në vazhdim të rigjëlberimit.

**VENDIM**  
**Nr. 457, datë 11.5.2006**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT “TV A 1”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Halil Lalaj	Kryetar
Sefedin Çela	Anëtar
Albert Minga	Anëtar
Visar Zhiti	Anëtar
Agim Duro	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKTI:** Rinovimin e licencës së subjektit televiziv “TV A 1”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 7 pika 21 dhe neni 25 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë RTV”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.08.2003 të KKRT-së, vendimi nr.441, datë 21.03.2006 i KKRT-së “Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV A 1”, si dhe neni 112, pika 2/a e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

**VËREN:**

Në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, subjekti shoqëria “TV Ballkan” sh.a., stacioni televiziv vendor “TV A 1” ka paraqitur dosjen e aplikimit për rinovim licence pranë KKRT-së. Zona e licencimit të këtij subjekti sipas licencës nr. 036/TVL është për prefekturat Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Fier.

Në mbledhjen e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit të datës 17.02.2006 rezultoi se subjekti TV A 1 ishte konform nenit 25 të ligjit dhe të pikës 4 të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë RTV” dhe kalonte për shqyrtim të mëtejshëm. Nga ana e anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit u përgatiten relacionet përkatëse. Departamenti Juridik dhe i Licencave bazuar në këto relacione përgati projektvendimin “Për rinovimin e licencës së subjektit TV A 1”. Ky projektvendim, së bashku me relacionet e secilit departament, iu paraqit për shqyrtim dhe procedurë të mëtejshme KKRT-së në mbledhjen e radhës së datës 21.03.2006.

Në këtë mbledhje KKRT me vendimin e saj nr. 441, datë 21.3.2006 “Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV A 1”, ka vendosur mosrinovimin e licencës për subjektin televiziv vendor privat TV A 1. Sipas pikës 2 të këtij vendimi, subjekti TV A 1 duhet të mbyllte transmetuesit e paautorizuar dhe të shlyente gjobën sipas vendimit nr.436, datë 21.03.2006 të KKRT-së.

Gjithashtu, për daljet jashtë zonës së licencimit në qytetet Shkodër dhe Korçë, subjekti TV A 1 është ndëshkuar me gjobën nr. 0118, datë 30.3.2006 në masën 1 000 000 lekë, e cila me vendimin nr.453, datë 27.04.2006 të KKRT-së është ulur në vlerën 500 000 lekë.

Në datën 10.5.2006 subjekti TV A 1 ka depozituar në KKRT pretendimet e tij, nëpërmjet shkresës me nr. 340 prot. ku kërkon rishikimin e vendimit nr.441, datë 21.3.2006. Ndër të tjera në këtë shkresë citohet se “... Vendimi nr.441, datë 21.3.2006 është në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 4 dhe 6, ku KKRT-ja ngarkohet të garantojë konkurrencën e ndershme dhe barazinë në trajtimin e kërkesave dhe kërkojnë anulimin e vendimit të mësipërm si të pambështetur në ligj dhe në standarde të barabarta me të gjithë operatorët...”.

KKRT, pasi u njoh me pretendimet e subjektit, konstaton se sanksionet me gjobë të vëna ndaj subjektit TV A 1 janë ndërmarrë pas datës 03.01.2006 (përkatësisht në datat 18.02.2006 dhe 30.03.2006), datë e cila shënon mbarimin e afatit të vlefshmërisë së licencës dhe në mbështetje të nenit 25 të ligjit, KKRT vendos për rinovimin e licencës në rastet kur subjekti ka qenë i rregullt gjatë kësaj periudhe dhe jo pas kësaj.

Për sa më sipër, sanksionet e vendosura ndaj subjektit TV A 1 pas datës 03.01.2006 nuk përbëjnë pengesë ligjore për mosrinovimin e licencës.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë RTV”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, vendimit nr.441, datë 21.03.2006 të KKRT-së “Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV A 1”, si dhe nenit 112, pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

#### **VENDOSI:**

1. Të shfuqizojë vendimin nr.441, datë 21.3.2006 të KKRT-së “Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor TV A 1”.
2. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 036/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “TV Ballkan” për televizionin “TV A 1”.
3. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: A.Minga, S.Çela, V.Zhiti, A.Duro.

#### **MENDIMI PAKICËS**

Vendimin e mësipërm e quaj të pambështetur në ligj dhe në rregulloret e KKRT-së. Citimi ligjor i nenit 25 në kontekstin e dhënë nuk është i aplikueshëm. Subjektit në fjalë i ka mbaruar afati i licencës me datë 03.01.2006, që do të thotë se pas këtij afati ky subjekt është duke operuar jashtë një licence të vlefshme. Komisioni përkatës në studimin e dosjes vërtet konstaton rregullshmërinë e këtij operatori gjatë periudhës së licencimit, por një vendim i marrë për rinovim licence, në kushtet e prezencës së shkeljeve ligjore të këtij operatori, është i palrregullt dhe i pambështetur.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

**VENDIM**  
**Nr. 458, datë 11.5.2006**

**PËR DHËNIE LICENCE**

**PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “DI-TV”**  
**SUBJEKTIT: SHOQËRIA “DI-TV” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, vendimit nr.341, datë 20.5.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “DI-TV” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Tiranës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

**VENDIM**  
**Nr. 460, datë 11.5.2006**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV GRAMSHI”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 162 të KKRT-së, të vendimit nr.434, datë 21.3.2006 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr. 004/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Kosturi” sh.p.k. për televizionin “TV Gramshi”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

**VENDIM**  
**Nr. 461, datë 11.5.2006**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV ARV”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.435, datë 21.3.2006 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.008/TVL, të rinovojë, për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “George” sh.p.k. për televizionin “TV ARV”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468**  
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

### **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
  - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
  - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
  - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
- 
- 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) ..... 1500**
  - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ..... 600**
  - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... 1500**
  - 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) ..... 1500**
- 
- 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... 1500**
  - 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... 2000**

### **BOTIME TË REJA**

- 1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT ..... 500**
- 2. KODI DOGANOR ..... 1000**
- 3. KODI DETAR ..... 1000**

Hyri në shtyp më 19.5.2006  
Doli nga shtypi më 22.5.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë